

GJYKATA SUPREME E

REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

07Su.nr.59/19

20.12.2019

Shkup

Në bazë të nenit 36 të Ligjit për shërbim gjyqësor (Gazeta zyrtare e RM nr.43,2014,33/2015, 98/2018, 198/2018), pas zbatimit të procedurës së publikuar sipas Shpalljes publike nr.1/2019 për punësim të nëpunësve gjyqësor në kohë të pacaktuar dhe Propozimin e Komisionit për përzgjedhje të nëpunësve gjyqësor për vendin e punës Këshilltar gjyqësor – Kategoria V, Niveli V1 – 5 (pesë) realizues të evidentuar nën 03Su.nr.672/19 nga 30.10.2019, Administratori gjyqësor i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, më 20.12.2019, solli

V E N D I M

Për zgjedhje për punësim

Për vendin e punës, Këshilltar gjyqësor – Kategoria V, Niveli V1 – 5 (pesë) realizues, zgjidhen kandidatët:

- Natasha Zlateska Terzovska
- Nevena Haxhi Panova
- Ljiljana Nikollovska
- Suza Micevska
- Aneta Ralev

Për kandidatët e zgjedhur do të sillen vendime për punësim.

A r s y e t i m

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, publikoi shpallje nr.1/2019 për punësim të nëpunësve gjyqësor në kohë të pacaktuar – për 5 (pesë) realizues në vendin e punës, Këshilltar gjyqësor – Kategoria V, Niveli V1, më 30.10.2019 në gazetën e përditshme “Nova Makedonija” dhe “Koha”.

Pas realizimit të procedurës së përzgjedhjes për punësim për vendin e punës Këshilltar gjyqësor Kategoria V, Niveli V1 - 5 (pesë) realizues, sipas Ligjit për shërbim gjyqësor dhe Rregullores për formën dhe përmbajtjen e shpalljes publike, formën, përmbajtjen dhe mënyrën e parashtrimit të fletëparaqitjes, të zbatimit të përzgjedhjes administrative, të provimeve, kontrollimit e besueshmërisë së dëshmive dhe të intervistës, si dhe mënyrën e pikëve të tyre dhe numrit maksimal të pikëve nga procedura e përzgjedhjes varësisht nga kategoritë e vendeve të punës, si dhe çështje tjera lidhur me procedurën e

punësimi të nëpunësve gjyqësor (Gazeta zyrtare e RM nr.236/2018 nga 24.12.2018), Komisioni i përzgjedhjes për punësim të nëpunësve gjyqësor për vendin e punës Këshilltar gjyqësor – Kategoria V, Niveli V1 deri në Administratorin gjyqësor të gjykatës dërgoi Propozim të kandidatëve për punësim për vendin e punës Këshilltar gjyqësor Kategoria V, Niveli V1 nën 03Su.nr.672/19-13 nga 18.12.2019. Me propozimin e nënvizuar, për vendin e punës Këshilltar gjyqësor Kategoria V, Niveli V1 - 5 (pesë) realizues propozohen kandidatët: Natasha Zlateska Terzovska, Nevena Haxhi Panova, Ljiljana Nikollovska, Suza Miceva dhe Aneta Ralev.

Në pajtim me nenin 36 paragrafi 1 të Ligjit për shërbim gjyqësor, administratori gjyqësor gjegjësisht kryetari i gjykatës ku nuk është zgjedhur administrator gjyqësor, në afat prej pesë ditëve pas pranimit të propozimit të kandidatëve për punësim, është i detyruar të sjellë vendim për zgjedhje.

Duke e pasur parasysh dispozitën e nënvizuar, si dhe Propozimin e kandidatëve për punësim për vendin e punës Këshilltar gjyqësor Kategoria V, Niveli V1 nën 03Su.nr.672/19-15 nga 18.12.2019, Administratori gjyqësor i gjykatës vendosi si në shqiptimin.

GJYKATA SUPREME E

REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Administrator gjyqësor

Sonja Gruevska

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij vendimi kandidati që nuk është zgjedhur ka të drejtë ankese në afat prej 8 (tetë) ditë nga dita e dërgimit të këtij vendimi për zgjedhje përmes Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut deri në Këshillin për shërbim gjyqësor.

UD:

- Administrata gjyqësore
- Në ueb faqen

- Biljana Sekovska Maneva
- Dançe Popeva Markoviq
- Marina Mileva
- Maja Kotevska
- Snezhana Dimitrovska
- Angella Pavlovska
- Elena Stefkovska
- Iskra Krstevska
- Fatmir Sabriu
- Vesna Ilievska
- Maja Nasteva
- Iva Avramovska
- Aleksandra Dimovska – Boshkovska
- Julija Koloska
- Petra Kabranova Nikollovska
- Sanja Filipovska

